

Të nderuar klientë,

Ju falenderojmë për marrëdhënien tuaj me Bankën Amerikane të Investimeve SHA. Kemi kënaqësinë t'ju njoftojmë se pas blerjes së suksesshme të Bankës NBG Albania SHA nga Banka Amerikane e Investimeve SHA dhe miratimit nga Banka e Shqipërisë, nga data 1 Tetor 2018, përmbillet procesi i bashkimit me përthithje dhe të dy banka bashkohen në një të vetme me emrin Banka Amerikane e Investimeve SHA.

Banka Amerikane e Investimeve SHA në tre vitet e fundit është një prej bankave më të suksesshme në Shqipëri me nivelin më të ulët të kredive të këqija, me rritjen më të shpejtë në tregun bankar dhe synon që me këtë bashkim të vijojë eksperiencën e saj pozitive, duke përfituar edhe nga eksperiencia e gjatë dhe shumë e vlefshme e Bankës NBG Albania gjë e cila është ndjerë edhe gjatë këtyre pak muajve me ABI si aksioner i Bankës. Të dy bankat e bashkuara me entuziazmin, dëshirën dhe eksperiencën e përbashkët do të shumëfishojnë mundësitë për të hedhur në treg më shumë produkte dhe shërbime të reja.

Jemi të lumtur për mundësinë që po na jepet për të forcuar më tej Bankën nëpërmjet përthithjes të Bankës NBG Albania SHA dhe ju sigurojmë se së bashku do të punojmë fort për t'ju konfirmuar se ju do të vazhdoni të merrni nga ana jonë shërbimin dhe asistencën profesionale që meritoni.

Në emër të Aksionarit të Bankës, Këshillit dhe stafit drejtues, ju falenderojmë dhe njëherë për marrëdhënien tuaj me Bankën NBG Albania. Ne do të vazhdojmë të ecim përpara çdo ditë e më shumë, për të bërë sa më shumë biznes së bashku.